



**QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
MINISTRIA E KULTURËS**

Në bazë të nenit 16 alinea (1) të Ligjit për kulturë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ бр. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16 и 11/18), Ministria e Kulturës shpall:

KONKURS

për ndarje të kompensimeve mujore

për artistët e pavarur për vitin 2022

I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Për stimulim dhe ndihmesë të krijimtarisë artistike për artistët e pavarur, Ministria e Kulturës për vitin 2022 do të sigurojë mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, si kompensim mujor për artistët e pavarur, për kontributet shëndetësore, sigurimin pensional dhe invalidor, dhe për tatimin e të ardhurave personale të artistëve të pavarur.

II. KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË KONKURS

Që t'ju ndahen kompensime mujore, artisti i pavarur duhet t'i përmbushë kushtet në vijim:

- të jetë i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut si tregtar individual, artist i pavarur për kryerje të veprimtarisë artistike në pajtim me Ligjin për kulturë dhe Ligjit për shoqëri tregtare;
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut me banim të vazhdueshëm/vendbanim në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- të mos ketë të realizuar të drejtë pensioni;
- të mos jetë student i rregullt.

Kompensim mujor mund t'i ndahet artistit të pavarur i cili krijon ose publikon vepra nga krijimtaria artistike, dhe i cili i plotëson sëpaku një nga kriteret e neneve 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 nga Rregullorja për përcaktimin e kushteve, kriterëve dhe procedurës për ndarje të kompensimeve mujore të mjeteve nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për kontributet shëndetësore, sigurimin pensional dhe invalidor dhe për tatimin e të ardhurave personale të artistëve të pavarur. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 252/21).

Veprat që krijon, gjegjësisht i publikon artisti i pavarur, duhet të jenë të publikuara (të botuara, të transportuara, të shfaqura, të paraqitura, të emituara nga radiofuzioni, të ekspozuara ose në mënyrë tjerë të vëna në dizpozicion të opinionit).

- Veprat që i krijon, gjegjësisht i publikon artisti i pavarur, duhet të:
- të jenë të dukshme për opinionin (veprat të jenë të publikuara në gazetat ditore dhe/ose në faqet e internetit, ose veprat të jenë të përfaqësuara dhe verifikuara nga ana kulturës vendore dhe skenës profesionale, ose për veprat artisti i pavarur ka fituar shpërblime vendore dhe/ose mirënjohje dhe/ose vështrime pozitive, recensione, kritika dhe publikime në media në Republikën e Maqedonisë së Veriut); ose
 - të afirmuar ndërkombëtarisht (për veprat të ketë të realizuara paraqitje ndërkombëtare, bashkëpunime, pjesëmarrje në manifestime ndërkombëtare dhe në ngjarje të tjera, ose për to, artisti i pavarur është shpërblyer me çmime ndërkombëtare dhe/ose mirënjohje, ose vështrime pozitive, recensione, kritika dhe publikime në medime jashtë vendit); ose
 - projekte që kanë qenë ose janë zgjedhur për projekte me interes nacional në Konkurset vjetore për financim të projekteve me interes nacional në kulturë, gjegjësisht në veprimtarinë e filmit, në pajtim me Ligjin për kulturë, gjegjësisht me Ligjin për veprimtari të filmit.

Rregullorja është e publikuar në veb faqen e Ministrisë së Kulturës www.kultura.gov.mk.

III. Mënyra e aplikimit dhe afati i dorëzimit të fletëparaqitjeve

- Fletëparaqitja, e cila është pjesë përbërëse e Konkursit, merret nga veb faqja e Ministrisë së Kulturës www.kultura.gov.mk dhe plotësohet në formë elektronike me futjen e të dhënave në vendin e shënuar, nënshkruhet dhe dorëzohet në formë të shtypur në Ministri të Kulturës.
- Fletëparaqitja me tërë dokumentacion përkatës (të theksuar në fletëparaqitje) dërgohet me postë në Ministrinë e Kulturës (rr. „Gjuro Gjakoviq“ nr. 61, 1000 Shkup), me datë në pullën postale, ose personalisht në ministri, më së voni deri më 15:30 në ditë pune.
- Nuk do të shqyrtohen fletëparaqitjet: të dorëzuara pas afatit të të konkursit, të plotësuara në formular joadekuat, të dorëzuara me postë elektronike, jo tërësisht të plotësuara dhe fletëparaqitje të pakompletuara pa dokumentacionin e detyrueshëm që kërkohet. Materialet e dorëzuara me fletëparaqitjet nuk kthehen.
- **Konkursi zgjat deri më 15.12.2021.**

IV. NJOFTIM PËR REZULTATET E KONKURSIT

- Të gjithë pjesëmarrësit e konkursit për rezultatet do të jenë të informuar në pajtim të Ligjit për kulturë.
- Me artistët e pavarur që kanë fituar në konkurs, Ministria e Kulturës do të bëjë marrëveshje individuale me secilin, me çka do të përcaktohen kushtet dhe obligimet e artistëve të pavarur për shfrytëzimin e kompensimit mujor.

V. INFORMATA PLOTËSUESE

- Për informata plotësuese, pjesëmarrësit e konkursit të drejtohen në Ministrinë e Kulturës tek nëpëunësi përgjegjës shtetëror për veprimtarinë përkatëse nga sfera e kulturës – në sektorin për veprimtari nga sfera e kulturës dhe artit, në tel. nr. 02/3240-547, 3240-548 dhe 3240-556, dhe në sektorin për veprimtari

botuese, në tel. nr. 02/3240-574 dhe 3240-575 – çdo ditë nga ora 9 deri më 15.

MINISTRIA E KULTURËS
rr. „Gjuro Gjakoviq“ nr. 61
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut
www.kultura.gov.mk